

ANALIZA STATISTIKORE PËR VITIN 2018 Viti 2018 shënoi rritje të madhe të numrit të pasagjerëve krahasuar me vitet e mëparshme. Trafiku ajror ka arritur në rritje dhe fluksi i udhëtarëve është shtuar ndjeshëm...

faqe 6



ICAO TRAJNIM NË AAC PËR ÇERTIFIKIMIN E AERODROMEVE Është zhvilluar kursi i asistencës teknike nën kornizën e iniciativës së "No Country Left Behind"...

faqe 8

SHKURT 2019 - Botimi X

posta ajrore



Buletini mujor i Autoritetit të Aviacionit Civil shqiptar

www.aac.gov.al | info@aca.gov.al

Tel: +355 4 22 51 220



KOMPENSIME

TË DREJTAT E PASAGJERIT, 1200 KOMPENSIME NË PROCES NGA KOMPANITË AJRORE
faqe 5

VONESA & ANULLIME JANAR 2019

FLY ERNEST PROBLEME ME VONESAT

Nga të dhënat zyrtare që vijnë nga TIA, rezulton se kompania me numrin më të madh të vonesave ka qenë kompania "Fly Ernest"...

faqe 4

AVIACIONI NË BOTË EUROCONTROL, VITI 2018 REKORD ME FLUTURIME DHE VONESA

Trafiku ajror në Europë u rrit me 3.8% gjatë vitit 2018 duke arritur një rekord krahasuar me vitet e mëparshme me 11,011,434 fluturime në total, me një rritje prej 30,168 fluturime krahasuar me 2017...

faqe 9



EASA AUDIT NË AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL EASA: REFORMAT KANË DHËNË REZULTAT POZITIV

Agjencia Europiane e Sigurisë teknike në Aviacion (EASA), zhvilloi një auditim në Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar në fund të muajit Janar. 3 inspektorët e EASA-s, kontrolluan ecurinë dhe aplikimin e rregulloreve nga ana e AAC. Në përfundim gjetjet e tyre rezultuan shumë pozitive për Autoritetin, duke rezultuar vetëm 4 gjetje nga 9 që ishin në vitin 2016. Auditimi nga EASA vjen vetëm pak ditë para vizitës së Drejtorit Ekzekutiv të këtij institucioni të rëndësishëm z.Patrick Ky, për një vizitë disa ditore në Shqipëri.

faqe 2-3

EASA: AUDIT NË AUTORITETETIN E AVIACIONIT CIVIL

Agjensia Europiane e Sigurisë teknike në Aviacion (EASA), zhvilloi një auditim në Autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar në fund të muajit Janar. 3 inspektorët e EASA-s, kontrolluan ecurinë dhe aplikimin e rregullorëve nga ana e AAC. Në përfundim gjetjet e tyre rezultuan shumë pozitive për Autoritetin, duke rezultuar vetëm 4 gjetje nga 9 të tilla që ishin në vitin 2016. Inspektorët vlerësuan angazhimin e AAC, që bëri të mundur përmirësimin e dukshëm të gjetjeve krahasuar më 2 vite më parë. Drejtori i AAC Krislen Keri, falenderoj EASA-s për mbështetjen e madhe që po i jep institucionit, si dhe i njohu 3 inspektorët me disa nga reformat e filluara 1 vit më parë dhe që po japin rezultate pozitive. Keri theksoi se reformat e ndërmarra janë bazuar në ato që kryen vetë EASA, si një model suksesi i agjencive botërore. Keri, në takimin përmbyllës falenderoj përzemërsisht funksionarët e EASA-s për punën e tyre dhe garantoj se masat që do të merren do të trajtohen me rigorozitet dhe do të ketë bashkëpunim me autoritet e mirënjohura të aviacionit civil në BE, si dhe do të mundësojë shtimin e stafit dhe buxhet më të madh për trajnimet dhe kualifikimet e inspektorëve. Agjensia Evropiane e Sigurisë Teknike në Aviacion (EASA) kryen vizita standardizuese në vendet e Bashkimit Europian, Lichtenstein, Islandë, Zvicër, Norvegji dhe shtetet e Marrëveshjes për Zonën



Në foto:
Inspektorët nga EASA së bashku me drejtorin e AAC, z. Krislen Keri dhe inspektorët e drejtorisë së DOAOM në AAC.

e Përbashkët të Aviacionit në Europë (ZPAE), pjesë e së cilës është dhe Shqipëria. Në muajin Janar ishte planifikuar dhe vizita standardizuese në Autoritetin e Aviacionit Civil, në Drejtorinë e Operatorëve Ajrore dhe Organizatave të Mirëmbajtjes, dhe Sektorit të Operimeve Ajrore dhe COA.

EASA: REFORMAT KANË DHËNË REZULTAT POZITIV



Në foto:
Inspektorët e EASA-s së bashku me inspektorët e AAC në takimin e mirëseardhjes nga z. Keri, në ambientet e AAC.

EASA: AUDIT NË AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL

Qëllimi i vizitës konsistoi në:

1. Zbatimin e Urdhrave/Udhëzimeve të Ministrit të cilat janë transpozime të rregullores kryesore europiane (Basic Regulation) dhe rregulloreve zbatuese të saj;
2. Kapacitetet dhe kompetencat e aktiviteteve të mbikëqyrjes;
3. Kontrolli i ecurisë dhe mbikëqyrjes për dy vitet e fundit për operatorin "Albawings", fazat e procesit të certifikimit fillestar të "Air Albania", procedurat e brendshme dhe të jashtme të autoritetit për operimet ajrore, trajnimet/kualifikimet e inspektorëve dhe audituesve të sektorit.

Konkluzionet më të rëndësishme të vizitës ishin:

1. Bashkëpunimi dhe qëndrimi i shkëlqyeshëm i stafit për diskutimet e hapura dhe konstruktive.
2. Motivimi dhe përkushtimi i stafit.
3. Ekspertiza e jashtme nga inspektorët e licencuar për kategorinë e avionëve.
4. Procedurat dhe manualët e sektorit në mënyrë të detajuar, strukturuar dhe aktualizuar. Funksione të strukturuar për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë ligjore dhe procesi i vlerësimit të riskut të sigurisë teknike.



Në foto:
Inspektorët nga EASA së bashku me drejtorin e AAC, z. Krislen Keri dhe inspektorët e drejtorisë së DOAOM në AAC.

Auditimi nga EASA vjen vetëm pak ditë para vizitës së Drejtorit Ekzekutiv të këtij institucioni të rëndësishëm z. Patrick Ky, që do të qëndrojë për disa ditë në Shqipëri.



Në foto:
Inspektorët e EASA-s së bashku me inspektorët e AAC në takimin e mirëseardhjes nga drejtori ekzekutiv z. Keri, në ambientet e AAC.



RAPORTI PERFORMANCËS:

JANAR 2019, KOMPANIA “FLY ERNEST” VIJON TË KETË PROBLEME ME VONESAT E FLUTURIMEVE

Muaji Janar paraqitet më i qetë sa i përket vonesave apo anulimit të fluturimeve nga kompanitë ajrore, po të krahasohet me muajin Dhjetor të 2018. Arsyeja e numrit të ulët të vonesave apo anulimeve, lidhet me uljet e fluksit të lëvizjes së pasagjerëve drejt dhe nga Aeroporti Ndërkombëtar “Nënë Tereza”. Nga të dhënat zyrtare që vijnë nga TIA, rezultojnë se kompania me numrin më të madh të vonesave ka qenë kompania “Fly Ernest”, me 7 fluturime me vonesë, një prej tyre mbi 6 orë, dhe me 1 anulim fluturimi. Kompania e dytë me më shumë vonesa renditet “Blue Panorama”, me vetëm 4 të tilla dhe asnjë anulim fluturimi. Një performancë e përmirësuar ndjeshëm nga kjo kompani krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Kompania e tretë është Adria Airways me 1 vonesë dhe 1 anulim gjatë muajit Janar. Siç tregohet edhe nga të dhënat zyrtare kompania më problematike vijon të jenë “Fly Ernest”, me destinacione disa qytete të Italisë. Muajt në vijim pritet të jenë normalë, kjo e lidhur me uljen e përqindjes së lëvizjes së pasagjerëve.

Më poshtë tabela përkatëse:




Tabela përkatëse për vonesat mbi 2 orë dhe anulime gjatë vitit 2018

TË DREJTAT E PASAGJERIT


1200 KOMPENSIME NË PROCES NGA KOMPANITË AJRORE, PËRVEÇ 700 PASAGJERËVE QË TASHMË JANË KOMPENSUAR. AAC I BËN APEL PASAGJERËVE QË TË KONTAKTOJNË MË KOMPANITË PËR TË PLOTËSUAR DOKUMENTACIONIN

Numri i kompensimeve për muajin Janar është i njëjtë, me muajin e kaluar. Aktualisht kompanitë ajrore kanë kompensuar me rreth 250 eu ose me bileta, rreth 700 pasagjerë që kanë plotësuar formularët e ankimit për shkak të vonesave apo anulimit të fluturimit të tyre. Pritet që në total numri i kompensimeve të rritet edhe më shumë pasi rreth 1200 formularë të tjerë ankimi janë pranuar nga kompanitë ajrore dhe janë në proces mbylljeje. Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar i bën apel gjithë pasagjerëve që kanë plotësuar formularët dhe i kanë dorëzuar, në mënyrë që të përfitojnë 250 eu kompensim, të komunikojnë me kompanitë që kanë plotësuar formularët sepse është e nevojshme verifikimi ose dërgimi i dokumenteve. Në rastet se ata do të hasin probleme, të kontaktojnë sektorin e të drejtave të pasagjerit të AAC në numrat e telefonit ose e-mailin si më poshtë. Nga të dhënat zyrtare kompania që respekton të drejtën e pasagjerëve për kompensim mbetet Blue Panorama, me rreth 500 të kompensime të mbyllura dhe një numër të madh në proces. Ndërsa më problematike mbetet kompania Fly Ernest me vetëm 96 të tilla, ndërkohë që renditet si kompania më problematike me numrin më të lartë të vonesave dhe anulimeve të fluturimeve. Kompania Wizz Air, gjithashtu ka kompensuar një numër të konsiderueshëm pasagjerësh të kompensuar duke shkuar në 74, pavarësisht se renditet ndër kompanitë më serioze në respektimin e orareve.


1200 

KËRKESA TË PRANUARA

AAC i bën thirrje gjithë pasagjerëve që kanë plotësuar formularët e ankimit dhe ka kaluar afati prej 6 javësh, që të rikontaktojnë përsëri kompanitë ajrore që kanë patur fluturimin për tu njohur me statusin e fluturimit të tyre. Në rast se kompania nuk i kthen asnjë përgjigje, atëherë të kontaktojnë me sektorin e të Drejtave të Pasagjerit të AAC-së në numrat e telefonit: **+355 42 381 959 / +355 44 539 959** ose me email tek: **pax@acaa.gov.al** dhe do të marrin asistencën e nevojshme. Për më shumë informacion vizitoni gjithashtu dhe linkun e mëposhtëm:



www.aac.gov.al/te-drejtat-e-pasagjerit



ANALIZA STATISTIKORE PËR VITIN 2018




■ **VITI 2018:** Viti 2018 shënoi rritje të madhe të numrit të pasagjerëve krahasuar me vitet e mëparshme. Trafiku ajror ka ardhur në rritje të vazhdueshme dhe fluksi i udhëtarëve është shtuar ndjeshëm. Por përveç një kërkesë në rritje të pasagjerëve që udhëtojnë nga dhe drejt TIA-s, viti 2018 shënoi edhe rritjen e numrit të kompanive të cilat operojnë me fluturimet e tyre në Shqipëri, duke krijuar edhe destinacione të reja në shërbimet e tyre. Sipas të dhënave zyrtare në vitin 2018 u arrit një shifër rekord për sa i përket numrit të pasagjerëve që kanë udhëtuar nëpërmjet linjave ajrore për/nga vendi ynë. 2,947,172 ishte numri i pasagjerëve përgjatë këtij viti, numër ky 12% më i lartë se ai i një viti më parë, ku shifrat shkuan në 2,630,338 pasagjerë. Pjesë e rëndësishme e të dhënave në rritje tashmë është edhe numri i lartë i turistëve të huaj të ardhur në vendin tonë, si dhe numri i kompanive të fluturimeve charter të cilat përgjatë muajve të verës rritën ndjeshëm jo vetëm numrin e pasagjerëve por edhe numrin e destinacioneve të reja.

Në Tabelën 1, pasqyrohet numri i pasagjerëve nga kompanitë ajrore dhe charter gjatë çdo muaji, për vitin 2018.

	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL VITI 2018
SHUMA	212,729	154,191	191,441	211,063	210,448	233,301	266,599	295,747	252,979	224,555	200,696	226,748	2,680,497
CHARTER	1462	324	721	588	9,669	44,392	79,311	80,543	46,375	1,796	981	513	266,675
TOTAL	214,191	154,515	192,162	211,651	220,117	277,693	345,910	376,290	299,354	226,351	201,677	227,261	2,947,172

Tabela 1:
Zotërimi në total i tregut sipas kompanive dhe charter përgjatë vitit 2018.




Grafiku 1:
Zotërimi i tregut nga ana e kompanive ajrore, sipas përqindjes:

■ **PËRQINDJET:** Fluksin më të madh të pasagjerëve përgjatë vitit 2018 duket se e mban kompania italiane "Blue Panorama" me 21% ndaj totalit. Ndjekur nga "Ernest S.p.A" me 12% ndaj totalit. "Albawings" gjithashtu ka një përqindje të lartë në zotërimin e tregut për vitin 2018 me një shifër totale prej 11%.

ANALIZA STATISTIKORE PËR VITIN 2018

NUMRI I PASAGJERËVE Për sa i përket anës tjetër të medaljes, kompanive që kanë pasur numrin më të ulët të pasagjerëve përgjatë vitit 2018, e fundit në listë mbetet kompania "Mistral Air", si rrjedhojë e ndërprerjes së operimeve në muajin Prill. Gjithashtu numër të ulët të pasagjerëve ka shënuar kompania "Volotea" me 14,516 pasagjerë në vit. Sikurse është theksuar periudha e Korrikut dhe Gushtit, janë muajt të cilët pasqyrojnë kulmin e kurbës për sa i përket numrit total të pasagjerëve në vitin 2018. Ky faktor vjen si rrjedhojë edhe e numrit të shtuar të kompanive Charter të cilat operuan në Shqipëri, ku gjatë këtij viti ishte në shifrat rekord krahasuar me vitet e kaluara.

Grafiku 2:
Numri i pasagjerëve përgjatë vitit 2018 sipas muajve



NUMRI I PASAGJERËVE Sipas shifrave në tabelën numër 2 pasqyrohet numri i pasagjerëve që kanë fluturuar me Charter përgjatë tre viteve të fundit, kjo kategori merr një fokus të veçantë ku përqindja e rritjes nga viti 2017 në vitin 2018 ka arritur në 55% dhe zë 9% të tregut në total. Shifrat për kategorinë e fluturimeve Charter priten të jenë në rritje përgjatë vitit 2019, duke qenë se turizmi ka qenë dhe një nga fokuset kryesore për vendin.

PASAGJERË Janar - Dhjetor 2016-2017-2018


Shoqëritë Ajrore	2016	2017	2018	% e ndryshimit 2017-2016	% e ndryshimit 2018-2017
				% e	% e
				2017-2016	2018-2017
Shuma	2,046,403	2,458,792	2,680,497	20.15%	9.02%
CHARTER	148,697	171,546	266,675	15.37%	55.45%
TOTAL	2,195,100	2,630,338	2,947,172	19.83%	12.05%
% charterit ndaj totalit	7%	7%	9%		

Tabela 2:
Numri i pasagjerëve sipas kompanive ajrore dhe charter përgjatë tre viteve të fundit.

KOMPANITË AJRORE Kompania që ka rritjen më të lartë të fluksit të pasagjerëve nga viti 2017 në vitin 2018 është kompania "Wizz Air", e cila që prej hyrjes në treg në fillim të vitit 2017 ka pasur shifra në rritje të vazhdueshme, kjo si pasojë e çmimeve low cost që ofron dhe shërbimit të mirë që kanë marrë pasagjerët. Grafiku nr. 3, pasqyron fakte për rritjen e fluksit në vitin 2018, që është 200% më e lartë se sa në vitin 2017.

Nga parashikimet dhe vlerësimet që vijnë nga ekspertët e aviacionit civil, pritet që edhe 2019 të regjistrojë rritje të numrit të pasagjerëve që udhëtojnë nga dhe drejt vendin tonë.

Grafiku3:
Numri i pasagjerëve për 2016, 2017, 2018 sipas kompanive ajrore.



AKTIVITETE TË DREJTORIVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL GJATË MUJIT JANAR

ICAO TRAJNIM NË AAC PËR ÇERTIFIKIMIN E AERODROMEVE

Në vijim të strategjisë për rritjen e kapaciteteve të inspektorëve të AAC-së në përmbushje të objektivave dhe detyrimeve mbikëqyrëse është zhvilluar kursi i asistencës teknike nën kornizën e iniciativës së "No Country Left Behind" nga zyra rajonale e ICAO-s në tematikën e Çertifikimit të Aerodromeve.

Në këtë nisëm rajonale me AAC si bashkë organizatore me ICAO-n, u mbledhën ekspertët më të mirë të fushave dhe nga Serbia dhe Bosnje dhe Hercegovina së bashku me ekspertët e AAC-s, për të shkëmbyer eksperiencat dhe praktikatat e mira dhe për tu përditësuar me zhvillimet më të fundit rregullatore.

Në këtë trajnim u trajtuan:

- Provizionet e ICAO-s në lidhje me certifikimin e aerodromeve duke përfshirë kornizën rregullatore, specifikimet e Manualeve
- Sistemi i menaxhimit të sigurisë, përditësimi i vazhdueshëm në programin USOAP

- PANS aerodromes, auditit dhe inspektimi. Në këtë trajnim morën pjesë tre ekspertët e ICAO-s në fushën e aerodromeve si dhe 12 inspektorë teknik nga Autoriteti i Aviacionit Civil shqiptar dhe nga vendet e rajonit.



Në foto:
gjatë trajnimit që u zhvillua pranë zyrave të AAC, me ekspertët e ICAO-s dhe inspektorët e AAC.

AAC, TRAJNIME PËR SITUATA EMERGJENTE KLIMATIKE

Drejtori i Sigurisë në Aviacion bashkë me përfaqësuesin e sektorit në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Shërbimit të Lundrimit Ajror, morën pjesë në workshopin e ushtrimeve të hirit vullkanik, grup i cili trajton ushtrimet në kuadrin e kësaj tematike për të zhvilluar plane dhe procedura për rajonin EUR-NAT. Në këtë takim u diskutuan masat

që duhet të merret në rastet kur ka shpërthime vullkanike, që sjellin edhe devijime apo bllokime të trafikut ajror në zonat ku shpërndahet hiri i vullkanit. Në këtë event që u zhvillua në qytetin e Napolit në Itali, morën pjesë përfaqësues nga shumë vende të rajonit të Ballkanit, që mund të preken në raste të aktivizimit të vullkanit ETNA.

AAC KURS PËR SIGURINË E AVIACIONIT CIVIL

Javën e fundit të muajit Dhjetor 2018, në Autoritetin e Aviacionit Civil, përfundoi kursi i trajnimit për sigurinë e aviacionit civil. I organizuar nën drejtimin e Instruktorit të AAC, ky kurs trajnimi kishte për qëllim, ofrimin e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen e aviacionit civil nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme. Pjesëmarrësit, punonjës në AAC, ndoqën me interes çështjet që përfshinë ky modul si, për aktet e mëparshme të ndërhyrjes së paligjshme ndaj aviacionit civil, aktet terroriste dhe kërcënimet aktuale si dhe u informuan për kuadrin rregullator për sigurinë e aviacionit, për objektivat dhe organizimin e sigurisë së aviacionit, duke përfshirë detyrimet dhe përgjegjësit e personave që implementojnë kontrollin e sigurie. Po kështu me pjesëmarrësit u ndan njohuritë mbi procedurat e kontrollit në hyrje, mbi sistemet e kartave të identifikimit që përdoren në aeroport, mbi procedurat për ndalimin e personave dhe rrethanat në të cilat personat duhet të ndalohen dhe raportohen për shkeljet e sigurisë apo sjelljet që

krijojnë dyshime për përfshirje në aktet e ndërhyrjes së paligjshme. Një temë tjetër interesante ishte ajo e njohjes dhe zhvillimit të aftësive për identifikimin e artikujve të ndaluar që nuk lejohet të mbarten në transportin ajror. Këtë kurs trajnimi e ndoqën 7 pjesëmarrës. Në përfundim, pjesëmarrësit u testuan për njohuritë dhe shprehën vlerësimet e tyre pozitive për organizimin e këtij kursi. Ata sugjeruan vazhdimin e kryerjes së këtij trajnimi për të krijuar një traditë të re të trajnimeve për punonjësit e rinj bazuar në burimet e vetë institucionit. Në një këndvështrim më të gjerë organizimi i trajnimeve në lidhje me sigurinë e aviacionit civil është një detyrë e çdo shteti anëtar të ICAO-s për implementimin e prioriteteve të Planit Global për Sigurinë e Aviacionit Civil (GASeP 2018) dhe një kontribut për rritjen e ndërgjegjësisë mbi sigurinë e aviacionit në zbatim të Rezolutës Nr. 2309 (2016) Kërcënimet ndaj paqes ndërkombëtare dhe sigurisë të shkaktuara nga aktet terroriste, të miratuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB.


Aviacioni

në Botë



EUROCONTROL, VITI 2018 REKORD ME FLUTURIME DHE


VONESA Trafiku ajror në Europë u rrit me 3.8% gjatë vitit 2018 duke arritur një rekord krahasuar me vitet e mëparshme me 11,011,434 fluturime në total, me një rritje prej 30,168 fluturime krahasuar me 2017. Duke u ndalur në detajet e dhëna nga Eurocontrol, rezultojnë se në 19 ditë pati më shumë se 36 mijë fluturime ditore, ndërsa dita me më shumë fluturime ose më e ngarkuara ishte në 7 Shtator, me 37 mijë e 101 fluturime në ditë. Rritje e konsiderueshme u regjistrua edhe në muajt nëntor dhe dhjetor 2018. Por kjo rritje



u pasua edhe me problemin e vonesave, ku sipas të dhënave që vijnë nga Brukseli, rezultojnë se pati 19 milion minuta vonesa me një rritje prej 105% krahasuar me vitin 2017. Duke u ndalur të shkaktojë e këtyre vonesave Eurocontrol i rendit si më poshtë:

1. Mungesë stafi ose kapacitetesh 60,4%
2. Kushtet atmosferike 25,3%
3. Grevat 14,3 %

Ulja e vonesave është një sfidë permanente edhe për 2019, ku një nga zgjidhjet e dhëna nga Eurocontrol është edhe gjetja ose zgjerimi i korridoreve aktuale ajrore, për të ulur fluksin e madh.



LAS VEGAS, SHBA: REKORD PASAGJERËSH 49,7 MILION NË 2018

Aeroporti i Las Vegas-it në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka regjistruar një numër rekord të pasagjerëve për vitin 2018 me 49 milion e 700 mijë. Sipas autoriteteve numri i lartë i pasagjerëve nuk është vetëm nga SHBA por edhe nga



shtete të tjera, që vizituan qytetin në shkretëtirë. Aeroporti "McCarran" në Las Vegas është hapur për herë të parë 70 vjet më parë, dhe që nga ajo periudhë ka regjistruar vetëm rritje të numrit të pasagjerëve.

SHBA POLICIA ARRESTON NË AEROPORT NJË TË RI

Policia në Aeroportin e Michiganit ka arrestuar një 20 vjeçar, me akuzën e mbështetjes së ISIS. I riu kishte udhëtuar disa herë në Mogadishu të Somalisë dhe kishte tërhequr vëmendjen e agjentëve të cilët bënë dhe arrestimin e tij. Hetimet ndaj të riut kishin filluar që në vitin 2016, kur në faqen e tij personale në Facebook, kishte shpërndarë materiale të ISIS. Bashkë me të policia arrestoi edhe të vëllain dhe një të afërm të cilët e ndihmuan duke blerë biletën e udhëtimit.

